



PSH .nr. 902/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, Z. Blerim Dina - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Atelea e Skulpturës Monomentale Agon Qosa” shpk- Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “ONIX-S” sh.p.k, Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilani”, me nr. të prokurimit: 651-20-5049-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Gjilan, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Atelea e Skulpturës Monomentale Agon Qosa” shpk- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilani”, me nr. të prokurimit: 651-20-5049-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Gjilan.

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilani”, me nr. të prokurimit: 651-20-5049-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Gjilan, dhe lënda kthehet ne **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Atelea e Skulpturës Monomentale Agon Qosa” shpk-Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Atelea e Skulpturës Monomentale Agon Qosa” shpk- Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 09.11.2020 me nr. 902/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilani”, me nr. të prokurimit: 651-20-5049-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Gjilan, duke pretenduar se:

- *Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1,7, 51, 52, 59, dhe 80 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 23.1 të dosjes së konkursit të projektimit*

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.11.2020, ka autorizuar eksperten shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 17.11.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe shkresave të lëndës sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e publikimit të njoftimit për dhënie të datës 23.10.2020, ofertën teknike të OE ankues e ka poentuar me 80 pikë dhe ofertën financiare me 20 pikë, kurse në pikët totale ka vendosur 52.98 pikë. Ndërsa, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 23.10.2020, operatorin ekonomik ankues e ka njoftuar se është poentuar me 52.98% apo 52.98 pikë. Në të njëjtën ditë, saktësisht me datë 23.10.2020 AK korrigjon njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke bërë përmirësimin në poentim të OE ankues. Në këtë njoftim të AK-së, pikët totale apo përqindjet totale të poentimit të OE ankues mbesin të njëjta por ndryshohet poentimi në ofertën financiare me 19.98% dhe ofertën teknike 33%, ku pas mbledhjes së pikëve totale apo përqindjes totale rezulton me poentim 52.98%.

Megjithatë, duhet të ceket se pas shqyrtimit të e-mailit të datës 29.10.2020 të autoritetit kontraktues drejtuar OE ankues, shihet që vet AK e pranon që ka bërë gabim teknik në pikët e publikuara në njoftimin për dhënie të kontratës dhe AK e pranon që ky gabim është vërejt pas kërkesës për ri shqyrtim nga ana e OE ankues.

Lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues mendon që është një gabim teknik i autoritetit kontraktues për faktin se në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar është përqindja e njëjtë me totalin e pikëve të publikuar në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Sa i përket anës estetike apo ofertës teknike të OE të rekomanduar dhe OE ankues, ku ankuesi pretendon se oferta e tij është më mirë dhe shihet nga personat laik, eksperti shqyrtues sqaron se nuk është në kompetencën e ekspertit që të bëjë vlerësim në aspektin artistik. Në kompetencë të ekspertit është që të konstatoj ana procedurale e aktivitetit të prokurimit. Pra, për këtë pretendim që ka të bëjë me ofertën teknike, eksperti nuk mund të jep konstatim.

Në pikën tjetër ankimore të OE ankues që ka të bëjë me anëtarët e jurisë profesionale janë koleg në fakultetin e arteve më profesorin, i cili është rekomanduar për kontratë dhe se juria profesionale ka qenë në dijeni me kodin apo shifrën 6666 të cilën e ka pasur OE i rekomanduar, eksperti shqyrtues sqaron se bazuar në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues të datës 27.10.2020 ky pretendim nuk është cekë. Andaj nenin 9.2 tek Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave thuhet: Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa AK të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 18.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 18.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar, Ne si OE , ATELEJA E SKULPTURES MONUMENTALE AGON QOSA SH.P.K nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, pasi që ne konsiderojmë që jemi oferta më e mirë dhe me e lirë për këtë tender.

Punimi jone artistik i plotëson të gjitha kërkesat e DT dhe jemi me çmim më të lire.

Për shkak se kemi të bëjmë me shtatoren e një Heroi të Kombit, AK Komuna Gjilan nuk duhet të bëjë gabimin që të vendosë për një punim i cili nuk i plotëson as për së afërmi elementet e personalitetit siç është Heroi Kombëtar” Kadri Zeka”

Andaj kërkoj nga PSH OSHP që këtë lënde ta kthej ne Ri Vleresim dhe NE të shpallemi fitues.

SQARIM

Të nderuar, Ne si OE , ATELEJA E SKULPTURES MONUMENTALE AGON QOSA SH.P.K nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, pasi që ne konsiderojmë që jemi oferta me e mirë dhe me e lirë për këtë tender. Punimi jone artistik i plotëson të gjitha kërkesat e DT dhe jemi me çmim më të lire.

Për shkak se kemi të bëjmë me shtatoren e një Heroi të Kombit, AK Komuna Gjilan nuk duhet të bëjë gabimin që të vendosë për një punim i cili nuk i plotëson as për së afërmi elementet e personalitetit siç është Heroi Kombëtar” Kadri Zeka” Andaj kërkoj nga PSH OSHP që këtë lënde ta kthej ne Ri Vleresim dhe NE të shpallemi fitues.

SQARIM ;

Atje ndodhi që komisioni prej tre anëtareve “profesor të artit” në Universitetin e Prishtinës përzgjidhen buletin më të dobët të kolegut të tyre Sabri Shaqiri - “Profesorit të çeramikës” në UP me shifrën 6666 dhe u vlerësua me 99.95 pikë

Komisioni ishte i përbërë prej:

1.Kryetar komisioni

Adem Rusinovci - Profesor i skulpturës në UP

2.Anëtar komisioni

Mehmet Behluli - Profesor i Pikturës në UP

3.Anëtar komisioni

Genc Reznici - profesor i artit dhe shkencave mediatike UP

Sipas kryetarit të komisionit Adem Rusinovci ata kishin zgjedhur buletin me shifrën 6666 se ishte ma e mira sipas tyre, që tha se ajo ishte:

1. Me kompozicion Artistikë më të mirë!

2. Më në karakter të figurës së Kadri Zekës!

3. Me Propërcione të sakta!

E vërteta është si në vijim

1. Kompozicioni artistik (levizja si do të dukej shtatorja)

- Heroi Kadri Zeka sipas historis së shkruar dhe tregimëve prej miqeve të tij ishte njeri i shkathtë me qëndrim krenar e burrëor dhe jo nënshtrues, Kurse kandidati i identifikuar me shifrën 6666 e ka paraqitur :nënshtrues, frigacak , dhe të shtangur.

2. Karakteri i portretit dhe figurës (ngjajshmëria e fëtyrës dhe trupit)

-Heroin Kadri Zeka e vran në moshën 29 vjeqare

Kurse kandidati i identifikuar me shifrën 6666 e ka paraqitur ne moshën 60-70vjeqare

D.M.TH nuk i ka dhan ngjajshmërin në portretë, as të figurës anatomike (trupore) të Heroit e as të moshës.

3. Proporcionet e figurës (elementët anatomike të trupit mes vete të një figure të sakt me $7\frac{1}{2}$ -shtatë koka e gjysm sipas kanunit ndërkombëtar për nje figur njerzore normale)

-Heroi Kadri Zeka ishte i gjat rreth 175cm

- Kurse kandidati i identifikuar me shifrën 6666 e ka paraqitur një figur të shtatëshkurtëve që në propëcione normale mund të ketë gjatësin rreth 110cm. (me $5\frac{1}{2}$ pesë koka e gjysm)

-Të bashkangjitura I keni fotot e skulptures së OE "ATELEJA E SKULPTURES MONUMENTALE AGON QOSA SH.P.K"me shifren 8888 nga skulptori Agon Qosa


-Edhe fotot e skulpturës së ONIX-S SH.P.K nga skulptori Sabri Shaqiri


Po ashtu edhe fotot me dimensione që paraqesin të drejten edhe të pa drejten.

Me respekt, ATELEJA E SKULPTURES MONUMENTALE AGON QOSA SH.P.K


Dhe skulptori Agon Qosa

VARIOUS STANDARDS OF PROPORTION






Skulptori
Agon Qosa
kodi 8888
pik 52.98%




APOXIOMENO LISIPO | Grécia antiga,
Escultura grega, Período clássico



Skulptori
Sabri Shaqiri
kodi 6666
pik 99.95%

Proporcionez e njeriut shtatë shkurtër









Skulptori
Agon Qosa
kodi 8888
pikë 52.98%



Skulptori
Sabri Shaqiri
kodi 6666
pik 99.95

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtrësit e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës me datë 23.10.2020, ofertën teknike të OE ankues e ka poentuar me 80 pikë dhe ofertën financiare me 20 pikë, kurse në pikët totale ka vendosur 52.98 pikë. Ndërsa, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 23.10.2020, operatorin ekonomik ankues e ka njoftuar se është poentuar me 52.98% apo 52.98 pikë. Në të njëjtën ditë, saktësisht me datë 23.10.2020 AK korrigjon njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke bërë përmirësimin në poentim të OE ankues. Në këtë njoftim të AK-së, pikët totale apo përqindjet totale të poentimit të OE ankues mbesin të njëjta por ndryshohet poentimi në ofertën financiare me 19.98% dhe ofertën teknike 33%, ku pas mbledhjes së pikëve totale apo përqindjes totale rezulton me poentim 52.98%.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të e-mailit të datës 29.10.2020 të autoritetit kontraktues drejtuar OE ankues, shihet që vet AK e pranon që ka bërë gabim teknik në pikët e publikuara në njoftimin për dhënie të kontratës dhe AK e pranon që ky gabim është vërejt pas kërkesës për ri shqyrtim nga ana e OE ankues. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson që është një gabim teknik i autoritetit kontraktues për faktin se në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar është përqindja e njëjtë me totalin e pikëve të publikuar në njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues.

Sa i përket anës estetike apo ofertës teknike të OE të rekomanduar dhe OE ankues, ku ankuesi pretendon se oferta e tij është më mirë dhe shihet nga personat laik, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se nuk është në kompetencën që të bëjë vlerësim në aspektin artistik. Në kompetencë të Paneli Shqyrtues është që të konstatoj ana procedurale të aktivitetit të prokurimit. Pra, për këtë pretendim që ka të bëjë me ofertën teknike estetike nuk mund të jepen vlerësime, pasi që ne jemi jurist dhe nuk e kemi profesionin adekuat siç e ka juria profesionale, por ne baze të provave të ofruara nga OE ankues shihet qarte se lënda duhet të kthehet në rivlerësim tek autoriteti kontraktues.

Në pikën tjetër ankimore të OE ankues që ka të bëjë me anëtarët e jurisë profesionale janë koleg në fakultetin e arteve më profesorin, i cili është rekomanduar për kontratë dhe se juria profesionale ka qenë në dijeni me

kodin apo shifrën 6666 të cilën e ka pasur OE i rekomanduar, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues të datës 27.10.2020 ky pretendim nuk është cekë. Andaj nenin 9.2 tek Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave thuhet: Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit “OSHP” dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t’i dorëzohet Autoritetit Kontraktues.

Paneli Shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, konsideron se autoriteti kontraktues duhet që aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeke Gjilani”, me nr. të prokurimit: 651-20-5049-4-2-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Gjilan ta kthej në rivlerësim dhe të respektohen në përpikëri dispozitat e LPP-se pjesa e PJESA III, RREGULLAT PËR KONKURSET E PROJEKTIMIT si dhe kërkesat e vendosura në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit lidhur me këtë aktivitet nga ana e Autoritetit Kontraktues KK Gjilan.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t’i dorëzohet:

- 1x1 AK- “KK Gjilan”
- 1x1 OE - “Atelea e Skulpturës Monomentale Agon Qosa” shpk- Ferizaj
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.